

Ref: 01/STIKK/2025

FTESË PËR OFERTIM: AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITET 2025-2027

- Datat e publikimit:** 20 janar 2025
- Data e mbylljes:** 1 shkurt 2025, ora 16:00
- Data e njoftimit:** Më së largu me 10 shkurt 2025
(Pas mbajtjes së Mbledhjes së Kuvendit që është e paraparë në shkurt 2025)
- Objekti i kontratës:** Marrëveshje e shërbimit
- Autoriteti kontraktues:** Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës (STIKK)

1. Hyrje

Si një katalizator në industrinë dinamike të teknologjisë, STIKK përshpejton rritjen dhe progresin në ekonomi. STIKK ofron një platformë që bashkon liderët e teknologjisë për t'u lidhur dhe bashkëpunuar me njëri-tjetrin dhe mbështet me entuziazëm anëtarët që shtynë përpara kufijtë e teknologjisë.

Që nga themelimi në 2008, STIKK arriti suksese të shumta dhe u bë një nga shtytësit kryesorë të industrisë së TIK-ut dhe komunitetit të TIK-ut në Kosovë. Gjatë përpjekjeve drejt zhvillimit të vazhdueshëm të industrisë së TIK, STIKK ka realizuar projekte të shumta që kanë për qëllim promovimin e sektorit të TIK të Kosovës, përmirësimin e kornizës ligjore, implementimin e hulumtimeve dhe analizave specifike të industrisë si dhe të ndihmojë në zhvillimin e profesional të aktorëve të sektorit.

STIKK fton kompanitë audituese që të ofertojnë për të kryer shërbimet e auditimit sipas IFRS dhe rregullave të ATK-së për vitet financiare prej **01.01.2025** deri me **31.12.2027**.

2. Kushtet dhe rregullat e kuotimit

Ofertuesit e interesuar, së bashku me ofertën duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin shtesë si në vijim:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit;
- Certifikata e regjistrimit fiskal;
- Licenca nga organet kompetente për kryerjen e punëve;
- Referenca mbi kryerjen e punëve të ngjashme;
- CV-të e auditorëve që do të bëjnë auditimin.

Oferta duhet të përmbajë:

- Planin gjeneral të auditimit;
- Afatin kohor të propozuar;
- Kërkesa për dokumentacionet që duhen të përgatiten paraprakisht nga ana e OJQ-së;
- Tarifat për auditorë;
- Shumën totale të auditimit (Në rast se çmimet dorëzohen pa e specifikuar TVSH-në, Shoqata do të konsiderojë se çmimi përfshinë TVSH-në).

3. Udhëzime për dorëzim të ofertave

- Ofruesit e Shërbimit duhet të dërgojnë ofertat e tyre, së bashku me të gjitha dokumentet e nevojshme, deri më **1 shkurt 2025**, ora **16:00**;
- Oferta duhet të dorëzohet përmes emailit info@stikk.org, shënuar ne subject numrin e ftesës për ofertim: **Ref: 01/STIKK/2025**;
- Ofertat do të vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme:

4. Kriteret e vlerësimit

Kriteri	%
1. Kriteret Kualitative	
1.1. Historiku dhe përvoja e Kompanisë/Personit Fizik	30
1.2. Referenca me detaje të kontaktit (<i>minimum 3 referenca</i>)	10
2. Kriteret Financiare	
2.1. Ofertë ekonomikisht më e favorshme	60
Totali:	100

5. E drejta për ankesë

Çdo ofertues ka të drejt për ankesë, të cilën mund të dërgoni në info@stikk.org brenda 7 ditëve kalendarik nga momenti i pranimit të emailit me rezultate nga Zyra Ekzekutive e STIKK.

Për cdo pyetje, mund të dërgoni kërkesë me shkrim përmes email-it në këtë adresë: info@stikk.org. Kërkesat pranohen deri më **31 Janar 2025**.